



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR LEGJISLACION,
TË MBAJTUR MË 1.02.2017**

SHKURT
2017

Mbledhjen e drejtoi kryetarja e Komisioni për Legjislacion, z. Albulena Haxhiju

KRYETARJA: Të nderuar të pranishëm,
Të nderuar anëtarë të Komisionit për Legjislacion,
Të nderuar përfaqësues të institucioneve, gjyqtarë, oda të përmbauesve të gjithë ju që jeni përfaqësues nga USAID-i, Banka Ekonomike të gjithë ju që jeni në këtë tryezë,
Ju faleminderit, që keni pranuar ftesën e Komisionit për Legjislacion për të qenë të pranishëm në këtë dëgjim publik që ka për qëllim marrjen e sugjerimeve, komenteve, qëndrimeve në lidhje me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-139 për procedurën përmbaimore.

Komisioni për Legjislacion ka formuar menjëherë pas miratimit në parim në Kuvendin e Kosovës ka miratuar grupin punues për të shqyrtuar këtë projektligj dhe fillimisht e kemi organizuar këtë dëgjim publik duke pasur parasysh faktin që shumë komente, shumë sugjerime, shumë vërejtje janë dhënë nga përfaqësues të ndryshëm qoftë shoqata e bankave ose përmbaues privatë por edhe qytetarë të tjerë të cilët na janë adresuar vërejtjet e tyre në Komisionin për Legjislacion.

Grupi punues udhëhiqet nga zoti Agim Ademaj, unë po ja kaloj fjalën zotit Ademaj në mënyrë që pastaj të kalojmë te përfaqësuesit në këtë tryezë. Zoti Ademaj.

AGIM ADEMAJ: Faleminderit, kryetare!
Përhëndetje për të gjithë të pranishmit,
Komisioni për Legjislacion pasi që ka kalua ky projektligj nëpër procedurat e nevojshme duke e përfshirë Ministrinë e Drejtësisë si propozues i këtij projektligji si dhe instanca tjera në Komisionin për Legjislacion dhe pastaj në lexim të parë në seancë plenare.

Në mes të këtyre dy dëgjimeve Komisioni ka formua grupin punues dhe sigurisht që e tha kryetarja ne kemi marrë me shkrim po i përmendi dy shqetësime kryesore të Odës së Përmbauesve që po e them kushtimishtë ka të bëjë me nenin 13 të ligjit bazë ose nenin 4 të këtij projektligji si dhe një shqetësim prapë me shkrim që e kemi marrë nga Shoqata e bankave të Kosovës që konsideroj që këtu do të sqarohen më në detale që kanë të bëjnë me disa afate që konsiderohen që janë të shkurta në projektligj.

Është me rëndësi që Ministria e Drejtësisë është këtu si propozuese e këtij projektligji. Ne si grup punues dhe si Komision do të ju dëgjojmë me të gjitha vërejtjet që i keni edhe rreth vetë projektligjit edhe nëse ka rreth procedurave që janë udhëheqë deri në këtë fazë.

Pastaj sigurisht grupi punues do të vazhdojë punën e vetë rreth vërejtjeve dhe propozimeve që ju sot do t'i jepni.

Unë për fillim kaq kryetare.

KRYETARJA: Faleminderit, shumë zoti Ademaj!

Unë nuk po flas në lidhje me qëndrimet e mia sa i përket këtij projektligji.

Fillimisht po e kaloj fjalën tek të pranishmit, madje në qoftë se ka edhe dikush tjetër në këtë sall të cilët janë në karika në qoftë se dëshirojnë ta marrin fjalën lirisht mund të ulen edhe ata në tavolinë.

Po ja kaloj fjalën përfaqësuesit të Ministrisë së Drejtësisë Adrian apo Baki cili do që jeni koordinuar në mënyrë që të na shpjegoni qëllimin e këtyre ndryshimeve dhe me qenë i propozuesit domethënë është kështu më dakord të vazhdojmë.

Vetëm ju kisha lutë që brenda pesë minutave të na japni qëndrimet natyrisht në qoftë se ka nevojë mund të dakordohemi për kohë shtesë por besë që brenda pesë minutave mund ta shpjegoni edhe qëndrimin e këtij projektligji. Ardian.

ARDIAN BAJRAKTARI : Faleminderit, kryetare!

Kam kënaqësinë që të ju përshëndes në emër të Ministrisë së Drejtësisë në cilësi të spozonrizuesit të këtij projektligji ju dhe deputetët gjithsesi edhe anëtarët të tjerë të pranishëm në këtë dëgjim.

Siç e dimë sistemi i përmbarimit përgjithësisht me theks të veçantë përmbarimit privat është njëra nga storjet e suksesit që kemi në vitet e fundit për faktin se ndër të tjera ka garantua realizimin e të drejtave të qytetarëve mbi bazën e vendimeve të organeve gjyqësore.

Ligji për përmbarimin privat përkatësisht Ligji për procedurën përmbarimore është hartuar në vitin 2013 dhe si i tillë ka fillua në dy faza të zbatohet dhe me qëllim të eliminimit të çfarëdo të mete ose vështirësi e cila është hasur gjatë kësaj periudhe, Ministria e Drejtësisë ka hartuar draftin përmes të cilit synon që të bëjë korrigjimin ose avancimin e mëtutjeshëm të legjislacionit të kësaj fushe.

Fokusi ynë përherë edhe në këtë rast është përmirësimi dhe avancimi i legjislacionit.

Mbi këtë bazë kemi hartua projektligjin duke u konsultuar me të gjithë akterët relevantë madje me përgjegjësi them se është njëri prej ligjeve që ka pasur konsultime të jashtëzakonshme dhe me këtë rast dua t'i falënderoj veçmas përfaqësuesit e Fondit Monetarë Ndërkombëtarë, përfaqësuesit e USAID-it, Bankës Qendrore, Shoqatës së Bankave, Odën e Përmbauesve, gjyqtarë të gjithë të tjerët të cilët në një formë ose në formë tjetër kanë dhënë kontributin e jashtëzakonshëm deri në finalizimin e këtij procesi.

Do të kemi parasysh kur kemi të bëjmë me projektligje të cilat në një formë ose formë tjetër tangojnë interesat e më shumë grupacioneve atëherë jo domosdoshmërisht është e natyrshme dakordimi në plotësi.

Mirëpo, megjithatë si Ministri e Drejtësisë kemi paraparë ose kemi synuar të arrijmë një qëllim madhor e që është të përkujdesemi që mbi të gjitha siguria juridike e qytetarëve të garantohet dhe të kemi parasysh interesin më të mirë të qytetarëve dhe jo të grupacioneve të ndryshme të interesit para së gjithash kanë obligim zbatimin e ligjit.

Mbi këtë bazë e thash edhe më përpara ka pasur konsultime shtesë edhe dakordime po thuaj se të plota përjashtimisht disa çështjeve që i ngriti edhe deputeti Ademaj në lidhje me çështjen e tarifës së efikasitetit, do ta kemi parasysh çka nënkupton tarifa e efikasitetit atëherë do të themi se është një tarifë e cila paguhet për shërbimin i cili kryhet brenda një afati ose një periudhe të caktuar.

Deri tash me thanë kjo ka qenë barë e debitorit, ndërsa me ndryshimet e fundit është përcaktua që një obligim i tillë t'i kalohet kreditorit.

Dhe pas marrëveshjes me përmbauesin gjë që konsiderojmë se debitori largohet nga një pjesë e përgjegjësisë, madje ka pasur raste që si rezultat i kësaj bare e cila është pagua në fillim të procesit ka pasur edhe institucione edhe firma të ndryshme që kanë shkua deri te falimentimi.

Megjithatë, vlen të theksohet se përmes këtij projektligji kemi paraparë edhe krijimin e një njësie të re e cila do të jetë kompetente për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së përmbaimit privat duke u fokusuar para së gjithash në

respektimin e ligjshmërisë si përfaqësues të autorizuar të cilët kryejnë autorizime publike.

Deri tash kjo ka qenë mbi bazën e vlerësimeve ad-hok edhe në Komisionin që e ka caktua Ministria.

Tash e tutje do të krijohet një njësi e veçantë e cila do të funksionoj në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Po ashtu një ndryshim do të thoja i rëndësishëm kur e ceka më përpara se kemi marrë parasysh interesin më të mirë të qytetarëve është edhe ndjeshmëria që kemi për shtresa të caktuara veçmas ata me asistencë sociale që do të lirohen nga kjo barë dhe konsiderojmë që përmes këtij projektligji janë adresuar një numër i konsiderueshëm i shqetësimeve të kësaj kategorie. Po ashtu, janë specifikuar afatet e ndërmarrjes së veprimeve nga ana e përmbaruesit, po ashtu çështja e prapësimit, si dhe çështja e ndërmarrjes së veprimeve nga banka duke nisur nga çështja e bllokimit të llogarive eventuale mbi bazën e një vendimi të formës së prerë.

Po ashtu, në refleksion të disa çështjeve që janë ngrit ndërkohë thënë Ministria e Drejtësisë së bashku me Fondin Monetar Ndërkombëtar, me përfaqësuesit e USAID-it, shoqatës së bankave, Odës së Përmbaruesve kanë arrit t'i bëjnë disa propozime, të cilat i kemi dërguar edhe me shkrim dhe po besoj që do të jenë objekt i diskutimi dhe në masë të konsiderueshme reflektojnë çështjet e ngritura nga ane e akterëve. E thashë edhe më përpara ka qenë dhe është në koordinim dhe në pajtim të plotë me Fondin Monetar Ndërkombëtar si pjesë e marrëveshjes stand by. Andaj Ministria e Drejtësisë edhe njëherë i falënderon të gjithë akterët që kanë dhënë kontributin dhe do të jetë ashtu si kemi qenë deri tash në projektligjet e tjera e gatshme të ofrojmë kontribute në fazat e mëvonshme të shqyrtimit të këtij projektligji nen për nen.

Jemi këtu së bashku edhe me dy kolegët e mi dhe do të përpiqemi të dhamë çfarëdo argumenti i cili mund të ngritet më pastaj. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Bajraktari!

Edhe unë dua të theksoj para të pranishmëve që janë në këtë takim, ka qenë e ftuar ministrja e Drejtësisë zonja Dhurata Hoxha. Zakonisht në dëgjimet publike është e udhës që të jenë të pranishëm ministrat për të arsyetuar projektligjin në fjalë, për shkak të mos krijimit të problemeve dhe vonesave të këtij projektligji unë pranova që ta përfaqësoni Ministrinë e Drejtësisë, mirëpo ia tërhiqni vërejtjen po ashtu ministres që në dëgjimet publike të paktën projektligjet të cilat vetë domethënë i

procedon të jetë e pranishme për t'i arsyetuar para komisionit, natyrisht edhe para Kuvendit.

Për shkak se kur e kemi shqyrtuar raportin e punës ka pas vërejtje nga anëtarët e komisionit që ministrja e Drejtësisë nuk po vjen në komision ose po i delegon përfaqësuesit e saj, kështu është tepër e rëndësishme prania e saj.

Jo besoj që roli i saj është për të qenë dhe për të dhënë llogari dhe në këtë drejtim është edhe vërejtja ime.

Kush e do fjalën nga përfaqësuesit që janë të pranishëm në këtë takim, po e nisim me gjyqtarin e Gjykatës së Apelit zotin Isa Shala.

ISA SHALA: Përshëndetje të gjithëve!

Unë do të jem i shkurt, sepse do të pranoj më shumë pyetje nëse ka. I tha edhe kolegu më herët, qëllimi është i këtyre ndryshimeve që të kemi një efikasitet më të madh në përmbartim, po ashtu që të kemi një kornizë të qartë ligjore sa i përket titujve përmbartimor, sepse kjo duhet të jetë edhe në harmoni me standardet evropiane, sidomos me rekomandimin e Këshillit të Evropës për përmbartim i cili thotë se nuk ka përmbartim të qartë po që se nuk i kemi titujt e qartë përmbartimor.

Edhe këtu kemi ndërhyrë në ndryshimet dhe plotësimet tona: të kemi një balancim ose një përcaktim të drejtë të palëve në procedurë, të kemi një mbrojtje të të drejtave të debitorit pavarësisht se ai është borxhli ai ka dinjitet, pastaj jemi munduar që të shkojmë, të përcaktojmë afate, të përcaktojmë shkurtimin e ankandëve, të kemi një mbikëqyrje nga gjykata në mënyrë që i tërë procesi të shkojë ashtu si duhet dhe përmbartuesit privat të kenë edhe një mbikëqyrje. Në kompetencë të gjykatave siç e dini ka mbetur çështjet kryesore që janë **dorëzimi i fëmijës** dhe çështjet e marrëdhënies së punës dhe statusore. Mirëpo ne përmes mjeteve juridike që janë në dispozicion të gjykatës së prapësimit dhe ankesave në tërë punën e përmbartuesit privat në njëfarë forme e kontrollojmë duke e shqyrtuar ligjshmërinë e vendimeve të tyre.

Për të qenë një përmbartim efikas, atëherë duhet të plotësohen katër kritere që janë: pavarësia, transparenca, efikasiteti dhe roli i institucioneve shtetërore. Ne me ndryshimet jemi munduar që të përcaktojmë edhe një bashkëpunim ndërinstitutional ndërmjet akterëve në procedurën e përmbartimit, sepse kjo ka ndodh që të kemi pengesa, sepse shumë institucione nuk kanë dhënë informacion dhe kjo ka qenë një pengesë në realizimin e përmbartimit.

Ndërsa, çështjet kryesore që i përmendi në fillim edhe kryetarja sa i përket tarifave më vonë do të japim edhe ne si gjykatë ndonjë interpretim në qoftë se është nevojshme. Ne si gjykatë, kemi parë se ka pengesa në interpretim të dispozitave kështu që mbi këto ndryshime sadopak ne mund të arrijmë që të mos ketë dilema rreth vendosjes së çështjeve. Edhe përkundër faktit se ligji është shumë i ri, ka hy në fuqi, më 1 janar 2014, po parashihet menjëherë nevoja që në 2017-ën ne të kemi plotësime dhe ndryshime pikërisht për shkak të atyre lëshimeve që janë bërë.

Këto propozime që i keni përpara janë propozime të vlefshme, me disa vërejtje që do t'i dhamë më vonë. Po ashtu, si gjykatë meqenëse përfaqësoj sistemin gjyqësor jam i gatshëm që të përgjigjem edhe nëse ka pyetje nga akterët tjerë.

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Shala! Fjalën e ka zonja Sherifi nga Oda e Përmbauesve Privat.

EMINE SHERIFI: Faleminderit, e nderuara kryetare!

I nderuari zoti Agim Ademaj, kryesues i Grupit Punues për plotësim ndryshim të Ligjit për procedurën përmbaimore.

Të nderuar anëtarë të grupit punues,

Të nderuar pjesëmarrës.

Oda e Përmbauesve Privat të Republikës së Kosovës që nga fillimi i punës në Grupin Punues të formuar me vendim të Ministrisë së Drejtësisë, ka dhënë kontributin profesional për plotësim ndryshimit të ligjit, duke marrë pjesë tre anëtarë nga Oda e Përmbauesve Privat, të cilët gjatë gjithë kohës kanë qenë prezentë në punimet e grupit punues dhe i gjithë grupi punues janë pajtuar që të aprovohet projektligji i cili ka shkuar për miratim në Ministrinë e Drejtësisë.

Oda e Përmbauesve Privat të Republikës së Kosovës ju njofton në lidhje me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për procedurën përmbaimore si në vijim: duke u nisur nga fakti që në Grupin Punues për plotësim dhe ndryshim të Ligjit të procedurës përmbaimore kanë marrë pjesë të gjitha grupet e interesit duke përfshirë Ministrinë e Drejtësisë, gjykatat, Odën e Përmbauesve, shoqatën e bankave, Bankën Qendrore e tjerë., si rezultat i këtij grupi punues është aprovuar projektligji me ndryshimet dhe plotësimet në të cilin neni 13, të ligjit aktual i ligjit bazë është formuluar në pajtim me të gjithë anëtarët e grupit punues dhe me formulimin në vijim.

Neni 13, i ligjit paragrafi 1, pas fjalës “kreditore” shtohet fjala përveç shpenzimeve lidhur me efikasitetin e zbatimit të përmbaimit. Neni 13 i ligjit pas paragrafit 4,

shtohet paragrafi i ri me tekstin si në vijim: “ përmbaruesi privat do të arkëtoj nga vlera e përmbaruar në procedurën e përmbarimit tarifën e efikasitetit për zbatimin e përmbarimit”. Ndërsa, neni 2 i projektligjit i aprovuar në Grupin Punues ka pësuar ndryshime substanciale, i cili nën tani në projektligjin Nr. 05/L-118 ka numrin e nenit 4, në formulimin që është bërë është në kundërshtim me projektligjin e aprovuar në grupin punues.

Vërejtjet dhe sugjerimet e Odës së Përmbaruesve Privat janë cekur në reagimin e të gjithë përmbaruesve, të cilët kanë të bëjnë në rend të parë me parimet e përgjithshme të drejtësisë, është kundër kushtetues, është në kundërshtim me ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës, nxit korrupsionin, pazarllëqet dhe në mes të palëve dhe përmbaruesve duke vënë në pikëpyetje tërë sistemin e përmbarimit, ngase kjo është ndërhyrje e drejtpërdrejtë me funksionin publik dhe në punën e përmbaruesit privat.

Për më tepër nenin 4 i projektligjit do t'i dëmtojë kreditorët dhe do t'u pamundësojë realizimin e të drejtave të tyre ku konkretisht është në kundërshtim edhe me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në mbrojtjen gjyqësore të të drejtave. Të nderuar, më lejoni të ju njoftoj, se në saje të bashkëpunimit që kemi me odat e përmbaruesve në rajon dhe me shtetet, ku përmbarimi privat funksionon për më tepër se 200 vjet, tarifa e efikasitetit paguhet nga ana e debitorit dhe atë me tarifë fikse, për arsye se kjo është tarifë e përcaktuar nga shteti, përcaktohet me udhëzim administrativ dhe në asnjë mënyrë funksionarëve publikë, të cilët i emëron shteti i Republikës së Kosovës, nuk do të duhej tu jepej mundësia që të bëjnë pazarllëqe, do të shkaktojë joseriozitet në nivel shtetëror. Prandaj, ju lutem që këtë ta keni në konsideratë të lartë.

Me keqardhje, më duhet të ju njoftoj, se edhe përkundër shumë takimeve dhe negociatave me aktorë të ndryshëm, anëtarët e odës edhe me tutje qëndrojnë pranë reagimit të nënshkruar, të cilin edhe ju e keni, nga të gjithë, se në rast se mbetet që tarifa e efikasitetit të arkëtohet nga kreditori me marrëveshje do ta bojkotojmë punën dhe këtë ekspozitë do ta dërgojnë në Gjykatën Kushtetuese për interpretim.

Andaj, të nderuar, ju lutem të keni mirëkuptim dhe çështjen në fjalë ta trajtoni në mënyrë objektive, duke pasur parasysh në rend të parë interesin e qytetarëve, duke u bazuar në argumentet dhe arsyetimet e paraqitura më lartë.

Unë si kryetare e Odës së Përmbaruesve Privatë, mora përgjegjësi pak më tepër që të kyçem dhe të them këtu para jush, kam bërë edhe njëfarë shkrimi, në mënyrë që të mos harroj ndonjë detaj, i cili është i rëndësishëm për t'ju bindur se kjo çfarë ka

ndodhur me Ligjin e procedurës përmbarimore, me propozimet që janë miratuar në Ministrinë e Drejtësisë për sa i përket nenit 13, është i dëmshëm për sistemin e përmbarimit dhe thjesht, do ta dëmtojë këtë funksion. Ata që duan ta mbajnë sistemin e përmbarimit privat, me këto pretendime, më e arsyeshme do të ishte ta mbyllin sistemin e përmbarimit privat komplet edhe t'i kthejnë lëndët në gjykata. Përkundër një efikasiteti të madh që ka pasur, përkundër një arsyeshmërie dhe një pune funksionale që ka ekzistuar deri më sot, ne si Odë e Përmbaruesve Privatë definitivisht shprehim shqetësimin këtu para jush edhe jemi tepër të habitur, se kujt i ka rënë ndërmend që shpenzimet e procedurës përmbarimore, shpenzimet e procedurës gjyqësore t'i arkëtohen personave ose palëve në procedurë, të cilët nuk kanë faj pse është iniciuar procedura. Nuk ka faj një qytetar i Republikës së Kosovës, ose një biznes, pse debitori nuk ia paguan mjetet. Ku është faji i tij? Pse atë ne duhet ta ngarkojmë me shpenzime?

Ndërkaq, për çështje tjera, për sa u përket dispozitave tjera ligjore, aty ku ne kemi dhënë edhe rekomandimet tona, qoftë me shkrim, qoftë në grupet punuese, ua kisha dhënë fjalën dy anëtarëve të grupit punues, nëse u lejohet nga ana e juaj. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zonja Sherife! Në qoftë se,... këndeje ende askush s'është paraqitur, por po vazhdojmë me anëtarët e grupit punues që kanë qenë të përfshirë në këto ndryshime. Vetëm prezantohu, për shkak të transkriptim dhe procesverbalit.

MEHDI RESHANI : Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar të pranishëm,

Ashtu siç ju informoj edhe kryetarja, që nga fillimi kemi qenë të kyçur në këtë grup punues dhe me gjithë punën e grupit punues, që është përfunduar, ka mbetur dhe është aprovuar versioni i Projektligjit për ndryshim dhe plotësim, ashtu siç është përfunduar në grupin punues, ku të njëjtin edhe ia kemi prezantuar edhe aktorëve dhe juve si institucion më herët, edhe Kuvendit, se si ka qenë versioni para se të bëhet ndryshimi, sa i përket pikërisht dispozitës së nenit 13, ligjit bazë.

Ne edhe në grupin punues jemi marrë vesh, që të gjitha komentet, propozimet dhe sugjerimet e identifikuar dhe të paraqitura, të cilat kanë nevojë të futen në Ligj, që nga Oda e Përmbaruesve të dorëzohen dhe të dërgohen me shkrim, të formuluar, të gatshme, që pastaj të përfshihen dhe të diskutohen për ndryshim në versionin final të Projektligjit, të cilat edhe i kemi prezantuar edhe i kemi paraqitur edhe në Kuvend, se cilat kanë qenë shqetësimet tona që janë identifikuar si sfida dhe të

cilat janë identifikuar si sfida, që krijojnë paqartësi, krijojnë telashe dhe ka nevojë që ligjin ta bëjmë sa më të qartë dhe sa më efikas.

Tash, unë nuk e di sa kemi kohë, sa më lejohet që t'i numërojmë, megjithëse këto edhe janë të paraqitura edhe me shkrim, dispozitat tjera, përveç nenit 13 të Ligjit bazik, kur në këtë ligj, nenin 4 të Projektligjit, por ne kemi pretenduar dhe kemi rekomanduar plotësisht, duke filluar që nga fillimi, shprehja e fjalës “përmbarues privat”. Duke pasur parasysh autorizimet publike edhe funksionet dhe kompetencat që i jepen përmbaruesit si organ përmbarues, paralel me gjykatësin përmbarues, në gjykatat themelore për lëndët që kanë nën kompetencë, po ashtu i njëjti është edhe në kundërshtim pikërisht me nenin 2, paragrafin 1.11, ku decidivisht thuhet se çfarë është përmbaruesi privat, te neni... të cilat, do të thotë a ka autorizime publike apo private.

Dispozitat tjetër... kemi thënë që neni 77 i Ligjit, te neni 77, paragrafi 5 i ligjit aktual, “...duhet të riformulohet për tu sqaruar si në vijim:...”, do të thotë nuk e di tash sa ka nevojë këto tua themi një nga një edhe si jemi me kohën, kryetare, a mundem?

KRYETARJA: Nëse ke mundësi, në pika të përgjithshme, do të thotë, edhe pse anëtarët e komisionit i kanë të gjitha, por po ashtu keni mundësi për të marr pjesë në Grupin Punues.

MEHDI RESHANI : Të gjitha këto i kemi identifikuar pikërisht për shkak të efikasitetit dhe për shkak të evitimit të zvarritjeve të procedurës dhe që të shkohet sa ë shumë kah ajo, që gjykata të shkarkohet nga lëndët e të mos ngarkohet edhe me lëndë të përmbaruesve privatë pa nevojë, aty ku nuk është nevoja.

Te neni 77, paragrafi 5 i Ligjit aktual, duhet të riformulohet për tu sqaruar si në vijim: “Ankesa kundër aktvendimit,...”, megjithëse kjo është pak a shumë, në këtë s’do tu merrija shumë kohë, se është i theksuar aty. Po ashtu, te paragrafi 4 i nenit 323, përfshihet për shkak se është kontradiktor me paragrafin 3 të të njëjtit nen, ose të riformulohet ky paragraf. I kemi dhënë ato formulime.

Neni 325, paragrafi 2, të formulohet si në vijim: “Kryetari i Gjykatës Themelore, brenda territorit të të cilit është emëruar përmbaruesi, vendos për përjashtimin e përmbaruesit.”, nga se edhe me Ligjin bazik i referohet plotësisht përjashtimit të përmbaruesit në mënyrë të përshtatshme me përjashtimin edhe të gjykatësit, nga kryetari i gjykatës, thjesht aty po shkojnë duke pasur dispozita kontradiktore, pa nevojë.

Te neni 331, paragrafi 1 të riformulohet si në vijim: “Personi i emëruar si përmbaues privat jep betimin para kryetarit të Republikës së Kosovës në afat prej 30 ditësh nga dita e emërimit.” Kjo i ka vlerësuar, ne i kemi vlerësuar si për, megjithëse të gjitha këto edhe pse kanë shkuar, asnjë nuk është përfshirë, fare nuk është **kuotuar** në grupin punues.

Pas nenit 37 të ligjit aktual shtohet edhe neni 338 dhe 339, me formulim si në vijim, ndërsa neni 338 i Ligjit aktual merr numrin 340 e kështu me radhë. Do të thotë, i kemi marrë të gatshme për të mos humbur shumë kohë edhe këtu.

Po shkojmë vetëm duke i përmendur dispozitat për të mos... te neni 339 duke pasur parasysh kompetencat dhe përgjegjësitë e përmbauesit, pikërisht në këtë pikë, si organ përmbaues, përmbauesi absolutisht është i pambrojtur dhe i nënshtruar në të gjitha procedurat për teke të dikujt edhe për veprimet, të cilat i rregullon me mjete juridike, ligji ka lënë mundësinë që të iniciohet një procedurë, çka kjo është në kundërshtim të plotë me pavarësinë e organit përmbaues. Do të thotë, thjesht edhe për veprimet, që kemi pasur raste që të njëjtat pretendime që i ka çua i kanë në komision disiplinor, lënda ka shkuar në gjykatë, komisioni disiplinor këndeje e ka trajtuar si shkelje, a gjykata e ka vendosur dhe vlerësuar që nuk ka pasur shkelje në veprimet përmbauese.

Do të thotë, ne do të shkojmë nga ajo që ta bëjmë një ligj sa më funksional dhe më të drejtë e që t’i ndihmojmë procedurës, dhe aty ku ka shkelje le të sqarohet e jo të konsiderohen shkelje edhe për veprimet për të cilat e ka të drejtën e mjetit juridik pala, sepse e ka edhe atë rrezik.

Pikërisht këtu e kemi bërë edhe ... formën 1.1. ... 365 dhe në fund të paragrafit 1 shtohet fjalia si në vijim “... por jo edhe për veprime të cilat mund të evitohen sipas dispozitave të nenit 5, paragrafi 5 dhe nenit 79”.

Do të thotë pikërisht me këto dispozita është paraparë shumë mirë mbikëqyrja e veprimit të organit përmbaues nga gjykatat.

Ka pasur raste kur për veprime të tilla, duke u bazuar në këtë ligj, janë shqiptuar dhe shpallur përgjegjës përmbauesi, thjeshtë në mënyrë absurde, sepse i është dhënë mundësia, dhe pikërisht prej komisionit disiplinor kemi pasur referime që duhet interesohej të intervenojë në ligj se ne thjeshtë për shkak të ligjit nuk kemi qare pa e zbatuar në formë të tillë.

(Ndërhyrje)

Po, neni 370... Po ashtu kemi bërë një riformulim, që konsiderojmë se me komisionin disiplinor është shkelur edhe parimi i dyshkallshmërisë të ligjit të procedurës së përgjithshme administrative që do të thotë se procedura administrative zhvillohet vetëm në një shkallë, që është e padrejtë, që do të thotë gjithmonë ligji ia garanton përdorimin e mjeteve juridike palës.

Dhe, po ashtu konsiderojmë se është në kundërshtim dhe në konflikt interesi nëse pagesa e anëtarëve të komisionit disiplinor bëhet nga buxheti i Odës së Përmbaruesve.

Automatikisht, motivi është se ka joobjektivitet aty.

KRYETARJA: Kam vërejtje nga anëtarët tjerë, për shkak të kohës...!

Mehdi Reshani: Në rregull! Atëherë, nëse janë të shkruara, e merr kohë, ne po e lëmë për kur ka mundësi ta përcjellim formulimin me shkrim, sepse më shpejt edhe s'po kemi mundësi ndryshe.

KRYETARJA: Grupi punues për secili propozim që e keni paraqitur para anëtarëve të Komisionit për Legjislacion, do ta arsyetoni në Grupin punues në përpikëri dhe detaje. E pastaj, varet nga vullneti i deputetëve nëse i marrim parasysh apo jo vërejtjet tuaja.

MEHDI RESHANI: Në rregull! Pra, s'po shoh arsyen që të ju marr kohë më shumë.

Faleminderit!

KRYETARJA: Përfaqësuesi nga Shoqata e Bankave, zoti Mentor Hajdaraj.

MENTOR HAJDARAJ: Faleminderit zonja Haxhiu! Përshëndetje të gjithëve!

Unë jam Mentor Hajdaraj, kryesues i Komitetit Ligjor në Shoqatën e Bankave të Kosovës dhe sot e përfaqësoj Shoqatën e Bankave.

Nëse do të kemi rast edhe ne të jemi pjesë e Grupit punues, atëherë për këto pjesët teknike nuk po ju marr kohë sot, dhe po fokusohem te katër pikat kryesore, të cilat i kemi identifikuar se janë më të rëndësishme për sektorin bankar.

Pika e parë, është neni 4 i Draftprojektligjit, që ka të bëjë me nenin 13, apo ndryshimet dhe plotësimet e nenit 13 të Ligjit bazik, e që ka të bëjë me negocimin e tarifave të efikasitetit.

Është e vërtet se në draftin e parë, nuk është ndryshuar, dhe nuk është përmendur më herët.

Dhe, po ashtu, është e vërtet se fillimisht e kemi kundërshtuar edhe ne këtë propozim që kreditori t'i bartë shpenzimet e efikasitetit, mirëpo pas analizave që i kemi bërë dhe praktikave më të mira që i kemi marrë prej vendeve që janë shumë më të zhvilluara se ne dhe se po besojmë të tentojmë që të shkojmë në atë rrugë, ne si Shoqatë e Bankave jemi të pajtimit të vazhdojmë me këtë propozim, edhe pse i vetmi grup i interesit që dëmtohet në këtë proces është pikërisht kreditori, e që në këtë rast janë bankat si kreditor më i madh në vend.

Shqetësimet e përmbauesve privatë pak mu dukën të ashpra ndoshta për shkak se ne si banka sigurisht se s'kemi tentuar të korruptojmë e as të bëjmë pazarllëqe. Dhe, ndoshta përmbauesit duhet të këqyrin pak pjesën e vet qysh do ta rregullojnë.

Pra, ne si kreditorë, edhe pse ne do ta bartim këtë barrë, jemi të pajtimit për hir të efikasitetit të procedurës dhe për hir të një të mire më të përgjithshme që është pajtimi me sponsorët e këtij ligji, nuk e shohim ndonjë problem, edhe pse po e potencoj se financiarisht kreditorët kanë me u dëmtua, por për të pasur pak më të qartë të pranishmit këtë tryezë, vetëm desha të sqaroj shkurt lidhur me pagesat që u bëhen përmbauesve.

Do të thotë, janë 3 lloje të pagesave me sistemin aktual. Është tarifa e efikasitetit, apo fillimisht, është taksa administrative, pastaj është pjesa e pagesave për veprimet procedurale. Do të thotë çdo veprim që e bëjnë përmbauesit, e kanë tarifën e caktuar me udhëzim administrativ, dhe në fund, është tarifa e efikasitetit.

Do të thotë, me këto ndryshime që janë propozuar në këtë draft-projektligj nuk është duke u ndryshuar komplet sistemi i pagesave.

Taksa administrative dhe veprimet procedurale do të mbesin të njëjta, por se çfarë po ndryshohet, është tarifa e efikasitetit. Dhe ne si kreditorë jemi të gatshëm të mbajmë si barrë me kushtin që shpresojmë ka me shty edhe më tutje të përmirësojë procesin e përmbaimit në Kosovë, rritjen e efikasitetit dhe njëkohësisht debitorëve t'u bëhet më të lehtë barrën e pagesave për shkak të kushteve me të cilat po jetojmë sot.

Pra, për këtë pjesë, më shumë nuk po vazhdoj.

Pjesa e dytë është neni 6 i Draftprojektligjit që lidhet me nenin 43 të Ligjit bazik. Edhe këtu bankat kanë bërë një kompromis, e kjo ka të bëjë me kalkulimin e interesit për urdhrat përmbarimor kur ne i pranojmë prej përmbaruesve dhe gjykatave.

Deri sot, kur banka e ka pranuar një urdhër përmbarimor për të ekzekutuar një vlerë të caktuar prej debitorit dhe kreditorit, organi përmbarues, përmbaruesi ose gjykata e ka pasur për obligim të caktojë edhe vlerën e interesit. Do të thotë, vlerën e shumë së mjeteve për interesin sa debitori i ka mbajtur paret borxh.

Tash me këtë ndryshim po kërkohet që bankat të bëjnë këtë kalkulim. Do të thotë, edhe për këtë pjesë ne jemi pajtuar, mirëpo me kusht që të rregullohet në atë mënyrë që të mos ketë keqinterpretime më vonë, që do të thotë këtu të obligohet organi përmbarimor për të caktuar sa është shkalla e interesit, mënyra si do të kalkulohet kjo dhe bankat në njëfarë mënyre ta bëjnë vetëm atë aktin final teknik e mos me u lënë përmbaruesve por ta bëjmë ne.

Edhe kjo besoj se do të ndihmojë pak procedurën e përmbarimit, pasi që përmbaruesit do ta kenë pak më lehtë ta kryejnë si proces sepse pjesën e kalkulimeve do ta bëjmë ne.

Pjesa tjetër, është te neni 19 i Draftprojektligjit që lidhet me nenin 155 të Ligjit bazik dhe kjo ka të bëjë me ekzekutimin e urdhrave përmbarimorë për transferin e mjeteve prej debitorit te kreditori.

Drafti fillestar ka qenë që bankat janë obliguar të veprojnë 60 minuta pas pranimit të urdhrit për transfer nga organi përmbarues.

Fillimisht ne kemi kërkuar që kjo kohë të jetë së paku deri ditën e ardhshme të punës, për shkak se në bankat munden nganjëherë që mos jenë për 60 minuta në zyre zyrtari që e bën këtë urdhër dhe pastaj mos të ketë hapësirë për ndonjë ndëshkim apo ankesë nga palët.

Pas negociatave me shumicën prej të pranishmëve këtu, ne kemi pranuar që kjo kohë të shtyhet në 3 orë – 180 minuta. Mirëpo, edhe këtu kërkojmë të rregullohet që këto 3 orë mos të jenë, ta zëmë me ardh në 16,30 urdhri përmbarimor dhe ne pastaj të obligohet zyrtari që punon në bankë të rri deri në 19,30, por ditën e ardhshme të punës.

Pra, edhe kjo besoj, gjatë punës së grupeve punuese do të sqarohet për t'u rregulluar.

Dhe pika e fundit, është neni 22 i Draftprojektligjit që lidhet me nenin 234 të Ligjit bazik dhe kjo është shumë me rëndësi për ne, e besoj edhe për përmbarues.

Prej ligjit bazik, tash siç është, ka ndryshim, sepse në Ligjit bazik tash janë 3 ankande publike, ndërsa është propozuar për shkak të shkurtimit të procedurave të përmbarimit të shkohet vetëm me 2 ankande.

Propozimi i parë i Draftligjit ka qenë që ankandi 1 të shkojë me $\frac{1}{2}$ të vlerës së pronës, të vlerësuar, dhe ankandi 2 me $\frac{1}{3}$.

Mirëpo, gjatë procedurave të ndryshme ka pasur ndryshim dhe tash është rritur ky prag, ku ankandi 1 është caktuar me $\frac{2}{3}$, do të thotë që të mos mund të shitet paluajtshmëria më pak se $\frac{2}{3}$ e vlerës që është vlerësuar dhe ankandi 1 jo më pak se 50% ose $\frac{1}{2}$.

Kërkesa jonë është që të ulet ky prag, sikur që ka qenë deri tash, do të thotë në draftin e parë, që ankandi i parë të shkojë jo me më pak se $\frac{1}{2}$ e vlerës së paluajtshme, dhe ankandi i parë të jetë me $\frac{1}{3}$. Do të thotë, tash funksionon ashtu, dhe vetëm është hequr një ankand.

Kemi arsye të ndryshme, dhe unë shpejt po e elaboroj. Do të thotë bankat kanë me qindra prona që i kanë ble, por e kanë shumë problem me i shitur për shkak të kushteve ku jetojmë dhe mentalitetit që e kemi këtu. Dhe, rritja e këtij pragu, do t'ua pamundësojë bankave me i ble pronat, të cilat i ka marrë në hipotekë. Për shembull, nëse një borxh është 100.000 euro dhe prona është po ashtu 100.000 euro, atëherë bankat duhet ta blejnë me $\frac{1}{2}$ që po i bie 50.000 ose 70.000 e nganjëherë edhe po tejkalohet vlera e borxhit.

Domethënë, bankat po detyrohen të blejnë një pronë që po kushton shumë më shtrenjtë se sa vetë vlera e borxhit. Pra, ka raste kur borxhi është 50.000 e pronën, në bazë të këtyre vlerësimeve, duhet blerë me 100.000, që po i bie 50.000 me i dhënë debitorit, dhe në njëfarë mënyre po i bie si shpërblim për mospagesat që i ka bërë te banka.

Unë besoj që këto më detajisht do t'i shqyrtojmë në Grupin punues, kështu që për sot s'ju kisha marrë kohë më shumë. Falënderoj për mundësinë që na e keni dhënë për t'i dhënë këto komente. Shpresoj se në grup punues, besoj do të merrni pjesë?

KRYETARJA: Patjetër se po! E kemi këtu edhe stafin e Komisionit që t'i merr nga ju të gjithë e-mailat tuaj, dhe natyrisht që do të ftoheni për secilin grup punues.

Urdhëroni, por paraprakisht ju lus të prezantoheni.

ARDI SHITA: Jam Ardi Shita, sekretar i Përgjithshëm i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Ju falënderoj për ftesën e nderuara kryetare, kryesues, deputetë,

Piksëpari desha ta përgëzoj Ministrinë e Drejtësisë për iniciativën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurë përmbarimore.

Edhe pse, sikur që tha edhe gjyqtari, ndoshta ka ndodhur shpejt, ka qenë e rëndësishme që ky ligj të hyjë në plotësim e ndryshim për shkak të disa mangësive që i ka pasur, veçanërisht te pjesa e prapësimeve dhe vonesave që kanë ardhur nga gjykatat.

Ne si komunitet i biznesit e kemi përcjell me vëmendje tërë procedurën e plotësimit-ndryshimit, i kemi marrë edhe ato që janë punuar në Grupin punues në Ministri të Drejtësisë.

Ne i pamë edhe kërkesat e përmbaruesve privatë, dhe për atë arsye vendosëm të vijmë sot të prezantojmë edhe qasjen tonë si sektor privat mbi tërë këtë proces.

E para, dëgjuam se ka qenë kërkesë eksplicite e Fondit Monetar Ndërkombëtar që barra të bartet nga kreditori. Pra, barra e pagesës së tarifës së suksesit.

Në shumicën e rasteve ne jemi kreditori. Pra, komuniteti i biznesit është shfrytëzuesi më i madh i përmbarimit privat.

Ashtu sikur që tha edhe kolegja nga Shoqata e Bankave nuk shohim asnjë pengesë nëse kjo ndodh, por gjithsesi, nëse flasim për bartjen e pagesës nga kreditori, do të flasim edhe për liberalizim të tarifave, për shkak se nuk është e mundshme që ne si kreditorë e shfrytëzues më të mëdhenj të këtij sistemi të obligohemi të paguajmë tarifën e suksesit, e në anën tjetër të na tregohet edhe shuma e saktë e asaj tarife të

suksesit dhe me na detyruar që mbi borxhin tonë, që dikush ndoshta e ka në vlerën 100.000 euro, ne të detyrohemi t'i paguajmë edhe 10.000 euro tarifë të suksesit.

Do të thotë, po flasim tash për liberalizim të tregut dhe të shkojmë drejt liberalizmit të tregut, ashtu sikur që e kanë edhe avokatët – kolegët e mi, të gjitha zyrat ligjore. Pra, flasim për një tarifë të negociuar për klientin në mënyrë që të gjithë ne duhet trajtuar si biznese.

Përmbaruesit privatë, përkundër kësaj, në kuadër të këtyre kanë kompetenca publike. Do të thotë kanë të deleguara funksionet publike, duhet të kihet parasysh se edhe këto janë biznese private. Një pjesë e madhe e tyre në shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, interesi i të cilave normalisht se është për të marrë tarifën e suksesit sa më të lartë, por problemi nga ana tjetër, ne që e paguajmë atë tarifë, është që ne duhet ofruar mundësinë të zgjedhim, me zgjedh përmbaruesin më të mirë i cili i ofron edhe tarifën më të mirë. Ky është qëllimi edhe i këtij tregu. Në të kundërtën, atëherë nuk duhet shkuar hiq për ndryshimin e strukturës për shkak se krijon shumë problem te sektori privat.

Çka është problemi më i madh, kryetare, kryesues? Problemi krijohet edhe në sektorin publik, për shkak se angazhimi i përmbaruesve momentalisht me procedura të prokurimit është i pamundshëm.

Dhe, çka ka me ofruar një përmbarues për dallim nga një përmbaruesi tjetër? Në një treg liberal, normalisht në procedura të prokurimit ku kursehet edhe buxheti i shtetit, flasim për përmbarues të cilët konkurrojnë në një tender si gjithkush tjetër.

Më erdh shumë keq kur dëgjova prej kryetares komentin mbi korruptimin dhe pazarllëqet. Sektori privat nuk është ai i cili korruptohet dhe bën pazarllëqe, dhe më vjen shumë keq nëse përmbaruesit dyshojnë në vetë kompetencën e kolegëve të tyre.

Qëllimi këtu nuk është të krijohet as korruptim e as pazarllëqe, por secili të marrë vlerën e shtuar, punën më të mirë dhe çmimin më të mirë.

Do të thotë po flasim për gjithë neve, që duhet paguar, ta marrim shërbimin e mirë me koston e mirë, përndryshe i humbë kuptimi gjithë sistemi.

Nëse ne detyrohemi që për shërbimet që i marrim të paguajmë tarifa fikse të larta, atëherë pse të shfrytëzohet sistemi i përmbarimit privat. Kjo shkakton bllokadë në ekonomi dhe shkakton, mbi të gjitha, probleme në relacion me klientët. Do të

thotë, flasim për atë se ne klientëve ose duhet me ua marrë 100% pagesat në avans ose nuk duhet ofruar shërbimin, për shkak se kostoja e përmbarimit është fikse, është e lartë dhe ne detyrohemi ta paguajmë.

Ky është një treg i lirë dhe konkurrenca është baza e këtij tregu të lirë. Është kategori kushtetuese. Tregu i lirë dhe konkurrenca në këtë Republikën e Kosovës është kategori kushtetuese. Nuk po di për çfarë kushtetutshmërie po flasim, kur në të vërtetë po shkojmë drejt këtij tregu të lirë të cilin e kemi obligim ligjor.

Unë nuk e di a ka pasur ndonjë hetim të kësaj situate prej autoritetit kombëtar të konkurrencës së Republikës së Kosovës dhe se në situatat në të cilat garantojnë pagesat fikse për të gjithë industrinë, për gjithë sektorin, dhe tash të përmbaruesve privatë, kjo me ligj definohet si kartell... Për shkak se kartelet i fiksojnë çmimet, i ofrojnë çmimet e njëjta, llojnë për çmime të njëjta, merren vesh për çmime të njëjta, dhe kjo e dëmton përfundimisht konsumatorin. Pse? Sepse ne, si sektor privat, Shoqata e Bankave, të gjithë përfaqësuesit e sektorit privat nëse na rritet kostoja, ku e reflektojmë atë kosto? Atë kosto do ta reflektojmë te konsumatori i fundit. Këtu është problemi.

Dhe, nëse neve na bëhet më e shtrenjtë të mblidhet borxhi, jemi të bindur të gjithë në Kuvend se ne do t'i ngritim çmimet.

Këtë nuk po e them si kërcënim, ashtu si po drejtohen me disa kërcënime – e ngrisim çështjen në Gjykatë Kushtetuese. Përkundrazi, po flasim për qëllimin më të mirë që konsumatori ose t'i mbajë çmimet e njëjta, ose t'i ketë çmimet më të ulëta, që bankat mos të shkojnë tash në rritje të kamatave të cilat mezi që i ulëm, mezi që i prumë në njëshifrore, për të shkohet tutje në zbritje të këtyre kamatave.

Të gjitha institucionet financiare, kompanitë private, çdo ngritje të kostos që u shkaktohet si rezultat i implikimeve rregullatore, sikur që janë ligjet apo aktet tjera, përfundimisht reflektojnë te kostoja ndaj konsumatorit.

Ky është qëndrimi im dhe ne këto qëndrime do t'i deponojmë edhe me shkrim drejt Grupit punues dhe t'i keni parasysh për hapa të mëtejshëm. Ju falënderoj shumë për kohën tuaj.

KRYETARJA: Faleminderit, po ashtu! A ka ndokush që do të marrë fjalën? Zoti Thompson nga USAID-i.

THOMPSON(Anglisht)

(gjatë diskutimit të Thompson, ndërpritet dëgjimi publik...)!!!

KRYETARJA: Faleminderit! Zoti Arifi, përmbaruesi privat,

SEFER ARIFI: Faleminderit!

Të nderuar të pranishëm,

Nuk po humbi kohë me ju drejtua secilit veç e veç a bënë, se është praktikë me ju drejtua secilit, por po shkoj drejtpërsëdrejti në ato që i dëgjova këtu.

Unë jam Sefer Arifi, përmbarues në Gjilan edhe anëtar i Bordit Ekzekutiv të Odës së Përmbaruesve Privat, privat na quajnë se kemi autorizime publike.

E para vërejte që e kisha paraqit këtu po edhe në grup punues, po dua me qenë i shkurt mos mu zgjerua shumë.

E falënderoj kryetaren që tha që në grupet punuese do të jeni të pranishëm, kjo është një send shumë i mirë, është një send që ne nuk e kemi ditë, ... një çështje që procedurën e Kuvendit nuk i dimë, ne nuk jemi politikan ne jemi profesionistë të çështjes parimore.

Është një fenomen shumë i keq te ne të gjithë këtu që jetojmë në Kosovë pa dallim kush jemi, kur pajtohemi për diçka e lëkundim kokën, kur nuk pajtohemi përqeshmi domethënë fillojmë me qesh, ... keq i i sheh të gjithë të pranishmit këtu për shembull kur pajtohen të gjithë thonë kështu veç se i shkon përshtati qajo, kur e shohin që nuk i shkon për shtati Sefeveri me ... nisin e përqeshin senet kjo nuk është e mirë.

Gjatë dëgjimit të fjalëve gjithë akterëve që keni këtu u dha një përgjigje se po krijohet një disbalanc, bankat po donë me marrë pagesën e taksës, bankat nuk janë vetë kreditorë.

Shoqata domethënë Ekonomike Amerikane tregon se do të rritet kosto, menjëherë filloj disbalanci, do të rritet domethënë pagesa.

Ne kemi pasur një praktik deri më sot interesant edhe prej ndërkombëtarëve edhe prej vendorëve po pajtohen të gjithë se ka qenë një storje e suksesit gjysmë storje këtë anglisht po e thonë nuk po thotë askush shqip sot, një histori apo një trevjeçar i suksesit, ka fillua sukses e ka shkarkua gjykatën, ka kthye diku mbi 100 milionë euro, kur kemi fillua punë ka qenë 13 përmbarues nuk kanë guxua me dal se është punë e ndihshme e rrezikshme edhe aty tash merren, dikush tren se sa kemi tarifë,

sa kemi këta kështu për me balancua me thanë që këta janë duke marrë shumë këta janë tu marrë para edhe ta japin përshtypin se këta janë duke u pasurua dikush mundet me qesh, domethënë përmbarues po pasurohen.

Më së pari ju kisha lutë sinqerisht nëse e bëni privat bëni privat edhe për gjyqtarë edhe për noterë edhe për të gjithë për gjithë aman mos e bëni veç për përmbarues se kemi kallëzime publike. Nuk ka qenë kërkesë, besomni, kam qenë i angazhuar personalisht e kam lanë zyrën me ditë të tëra unë dhe Mehdi Reshani edhe kryetarja, me ditë të tëra kemi qenë në takime në grupe punuese nuk ka qenë kërkesë e Fondit Monetarë Ndërkombëtarë tash mujë me thanë që është kërkesë edhe mujë me e fut këtë kërkesë edhe mujë me thanë, nuk ka qenë kërkesë absolutisht ju garantoj. Nëse Ministria e Drejtësisë bëhet e drejtë se e drejtësisë edhe thotë që kanë qenë katër kritere apo pesë për me i futë në të gjithë jemi pajtua që me i mbajtë ato kritere edhe me i futë edhe i kemi vendos.

Besoni pse dal unë para juve këtu edhe flas për tarifën e efikasitetit kur në jetë nuk e kisha besuar.

Ka qenë kërkesë e jona besomëni, nëse i kemi ato procesverbale edhe në qoftë se bohen real të gjithë akterët që janë këto besomëni që ka qenë kërkesë e jona për shkak të përmbaruesve që e kanë keqinterpretua nenin 13, tarifën e efikasitetit e ka marrë përpara ose përmasë po janë në procedurë të hetimeve, nuk janë engjëj të gjithë, kanë shkua e kanë marrë. Kemi kërkuar që të bëhet me vlerën e përmbaruar edhe të mirret pas vlerës, nuk ka ... askush edhe jemi dakordua... ka shkua në ministri, brenda natës ka ndërrua ai ligj, ka ardhur në Kuvend, besoni kur e kemi pa e kemi pa pas leximit të parë, ka kalua domethënë një fazë shumë të gjatë.

Ne si akter ne që po e zbatojmë, ne që po thojmë jemi të suksesit që e kemi marrë riskun, .. le të punojnë krejt përmbaruesit në qoftë se ju jetë marrak.

Kjo tash po krijon pazar, kjo pazar .. nuk bëhet pazar me drejtësinë zonja kryetare, ju jeni juriste, qysh bënë pazar ti me një autorizim publik që tu ka dhënë edhe me hy në marrëveshje me drejtorin, ky ... koston, ai tjetri thotë nuk pranojmë po ju nuk jeni debi kreditor këtu.

KRYETARI: Ju kisha lutë mos me ju ndërhy njëri tjetrit por mos me pas qëllime tendencioze, zoti Arifi, mos ta personalizojmë debatit ju kisha lutë, jo personalizim i debatit.

SEFER ARIFI: Nuk është asnjë dëm kryetare dhe kryesues nuk është në asnjë vend të rajonit. Ne kemi lidhur memorandumin me të gjitha shtetet e rajonit besomëni edhe kemi shkua nëpër ... gjysh e ka tarifën .. rajonit Kosova është eksperiment a, nuk është ,, fikse, gjysmë ore i ka tarifë fikse, ligjet pozitive i kanë tarifë fikse nuk guxon mu bë Pazar me drejtësinë, me ligjin nuk bëhet Pazar ata që japin komente të ndryshe.

Ju kisha lutë që ta keni parasysh se Kosovën nuk bon me marrë si eksperiment me këto ligje edhe me na pru në një situatë kur kemi bë ne reagim, ku e kanë nënshkrua 34 përmbaues që janë shumë serioze që kanë me e lënë punën, që kanë me u

Ju lutem mosni se ne jemi persona të .. shtetërore, kemi krye edhe provime profesionale edhe nuk mbesim pa punë, ne kemi dal prej punëve më të mira në këtë punë edhe dikush mendon se ju jeni tu u pasurua. Në qoftë se dikush donë me u pasurua ka konkurse sa të duash edhe për 40-50 përmbaues.

A e shihni se të gjithë flasin për suksesin i cili nuk është bë prej 2000-it deri më sot e prej përmbauesve është bërë jashtëzakonshëm 100 milionë i janë kthyer kreditor edhe shumica tash krejt flasin për këtë tarifën e efikasitetit nuk jeni veç ju, ka njeri 20 vjet tu e ndjekë drejtësinë 20 vjet edhe ne jemi ardhur me ta urua tye .. përmbaimore, a paguan procedurë kontestimore jo, ai më kuptoj.

Është një fenomen i keq, nuk është kjo praktikë e rajonit besoj që ... tjera. ju lutna që t'i marrin praktikën më të mira mos të bëjmë eksperimente me këto ligje, mos na bini situatën që ne me thanë që ku i keni licencat vazhdoni ju se nuk është punë e lehtë, besomni nuk të vjen njeri kërcënohet e të shanë, e të ofendon edhe bile bile ka edhe rrahje, edhe kanë rrahë përmbaues, .. na vrasin, se dikush Faleminderit!

Veç kemi shqetësim të jashtëzakonshëm që na keni prua në këtë situatë, e ne vetë kemi kërkua nenin 13 me e ndryshua e tash po bëhet gjithë ky debat po çelët se tash janë çelur muhabetet edhe secili në atë këndin e vetë. Besoni se ne kemi kërkua mes nesh me e sqarua vlerën e përmbaues edhe prej debitori, nuk guxon mu ... ai që e humb ai paguan. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Arifi!

Nga të pranishmit a dëshiron dikush fjalën apo po e kaloj te deputeti Aliu.

AGIM ALIU: Faleminderit, zonja kryetare!

Ju përshëndes të gjithëve,
Përfaqësuesin e ministrisë,
Shoqatës së bankave,
Përmbauesve privat,
Gjykatës së Apelit,
Sigurisht për miqtë për partnerë tanë që janë mbështetës të shumë projektligjeve
dhe sigurisht se edhe në këtë ligj e kanë dhënë kontributin e tyre.

Unë besoj se na ka shërbye mirë ky dëgjim publik pavarësisht se nga fundi janë duke u ngritë tone edhe duke u bërë edhe vlerësime të mimikës edhe çështjeve tjera që ... që ishin pak të domosdoshme për këtë takim.

ne jemi për të dëgjuar argumentet në mënyrë që me nxjerr një ligj i cili do t'i shërben të mbi të gjithë vendit, qytetarëve por edhe gjithë akterëve që janë pjesë e këtij projektligji.

Duke pasur parasysh një fakt pse ka ardhur deri te ky plotësim edhe ndryshim i ligjit.

Çfarë kemi dëgjuar ne edhe pa qenë deputetë apo pa qenë pozita të tilla gjatë këtyre dy viteve prej kohës në fuqi një ligj i tillë siguri se kemi dëgjuar shumë shqetësime, por më së shumti që kemi dëgjuar shqetësime kanë qenë pikërisht shqetësime të qytetarëve.

Më vjen mirë që u ngrit një çështje me të drejtë u ngrit nga zoti Shala, çështja e të drejtave debitor, nuk do të thotë tash pse janë borxhlinj edhe tash t'i mbysim krejt, nëse do të duhej të jemi tepër të kujdesshëm ndaj gjithë kësaj klientele dhe ndaj gjithë të gjithë këtyre njerëzve.

Prandaj, unë besoj se ky projektligj pavarësisht rreth këtyre çështjeve dhe ... edhe argumenteve që u ngritën edhe nga Oda e Përmbauesve në fakt nëse diçka edhe unë personalisht në momentin e parë kur ka ardhur projektligji mendoj në shqyrtim në Komision kish qenë pikërisht letra e juaj edhe me shumë shqetësim e kemi marrë se çfarë vërtetë është duke ndodhë me projektligjin kur ne jemi në një pozitë të tillë çfarë u vumë edhe sot.

Unë mendoj se nuk është qasje e drejtë nëse ne përdorim siç thotë populli fjalën e mbram me i qitë të parët nuk është mirë.

Mendoj se je jemi këtu bashkë për të bërë më të mirë për vendin edhe mund ta bëjmë më të mirë për vendin sot është një hap nesër mund të jetë edhe një hap tjetër. Por ne përfaqësojmë këtu dikon, ne jemi deputetë, thirrme përfaqësues të organizatave të ndryshme, ne shpesh thirrim në emër të qytetarëve por megjithatë sot tamam ata qytetarë autentik nuk i kemi në këtë dëgjim publik, a të provojmë të futemi në lëkurën e tyre si ata janë duke e ndjerë në lëkurën e tyre këtë ligj respektivisht çështjen e përmbaruesve.

Mendoj se duhet të bëhemi real jo vetëm të shohim vetëm nga prizmi personal sepse përgjatë këtyre dy viteve unë kam dëgjuar shumë vërejtje sa i përket implementimin edhe është shumë mirë që ka ardhur ky projektligj edhe që ne po e ndryshojmë. Ndoshta nuk është prapë më i mirë por ne do të punojmë, ne do të vazhdojmë, nuk është hera e parë që jeni duke shqyrtuar këtu për plotësim ndryshime të ligjit.

Vetëm për dy vite edhe pse ju e dini që ky legjislacion është ballafaqua me probleme nga më të ndryshmet, kemi shqyrtua nga 2-3 herë ligje dhe kemi mendua me i ndryshua dhe me i harmonizua edhe me standarde ndërkombëtare.

Është fat i joni që i kemi edhe USAID-in edhe Fondin Monetarë Ndërkombëtarë edhe mekanizma tjerë partnerë që pikërisht na ndihmojnë që të bëjmë për ligje të BE-së jo të rajonit

Nuk janë shembujt më të mirë shembujt e rajonit. Bëjeni të bindur që ne posa edhe jemi kthye para disa ditës në një vizitë në Shqipëri dhe vizita tjera ata gjithmonë ne na marrin shembull për ligje, është çështje tjetër sa implementohen ligjet në Kosovë kjo është çështje në vete dhe mund të diskutojmë gjerë e gjatë edhe me vite të tëra sa i përket interpretimit jo vetëm të këtij ligji por të shumë ligjeve në Kosovë dhe kjo është çështja në fakt kryesore në Kosovë.

Por legjislacioni jonë është legjislacion jashtëzakonisht i avancuar pavarësisht që e thash ne po kemi telashe në ndonjëherë plotësim edhe ndryshim.

Mirëpo, po besoj që me këto projekte që u tha edhe në mundësinë që do ta kemi nëse është nevoja dhjetë takime, njëzet takime sa të dom kemi me bë takime në mënyrë që në fund me nxjerr një ligj i cili vërtetë është ai që do të duhej të ishte. Pavarësisht se do të ketë sigurisht çështje që nuk do të jetë pjesë e adresimit sepse ne nuk mundemi me e ndryshua atë tërësisht.

Ne jemi po ashtu në lexim të dytë edhe të disa ligjeve tjera dhe po ndodhë e njëjta gjë. Paramendo ne e kemi një ligj që do të vije, nuk është në Komisionin tonë Ligji për automjetet dhe sa nenet i ka ai ligj shumë pak janë duke u marrë njerëzit me nene të tjera përveç me nenin që ka të bëjë mbi monopolin.

Ju e dini si është çështja e homologimit në Kosovë. Prandaj, e kam dëgjuar shumë me kujdes edhe zotin Shita dhe ka prekë shumë çështje me rëndësi të veçantë që nuk do të duhej të kenë vetëm për këtë ligj, këto janë edhe për çështje të tjera për ligje të tjera.

Ne pas këtij projektligji kemi me pas me kolegët e juaj noterë edhe ata janë duke u grumbullua kështu si ju, edhe ata janë u grumbullua se si ta zhblllokojmë problemin e tyre. Ata kanë çështje e proporcionit po do të kenë edhe probleme të tjera që do të ngrisin sigurisht ata.

Unë mendoj se përtej interesave të grupeve që kemi, shoqatave që kemi unë mendoj që duhet të ulemi nga pakë dhe të shohim edhe interesat e qytetarëve.

Thjeshtë bëjmë kompromise të mundura, por jo duke cenua substancën e veprimit të cilido profesionalist në këtë rast edhe mos me cenua krejt punën e juaj.

Unë mendoj që me një racionalitet edhe nga ana e juaj po edhe nga ana e jonë këtu edhe gjithë akterëve që do të jemi pjesë e grupit punues besoj se të organizojmë ma të mirën Faleminderit, të gjithëve!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Aliu! A ka dikush tjetër nga të pranishmit që dëshiron fjalën.

MEHDI RESHANI: Faleminderit, kryetare!

Vetëm desha një fakt ta potencon se vazhdimisht po përmendet fjala qytetar po mendohet që si qytetarë dhe si palë është vetëm debitori, po harrojmë që .. thjeshtë reciproke aq sa kemi debitor aq kemi edhe kreditor dhe nuk e di tash a duhet në këtë rast mu harrua thjeshtë interesi i pazgjedhur i qytetarit që është kreditor e të ketë parasysh veç interesi i palës që është debitorë.

Pikërisht edhe në tekst të betimit të këtij ligji na obligon që me i trajtua palët në mënyrë të barabartë dhe në mënyrë të njëjtë edhe me u mbrojt dinjiteti i secilit.

Nuk e di pse mundem me ndodhë që gjithë .. kreditori po mendohet sipas diskutimeve dhe sipas pretendimeve për mendimin tim kreditori po shikohet vetëm

si sulmues a nuk po shikohet si ai që është, ai është i pari në hallë se ai po kërkon të drejtën të cilën nuk ju ka dhënë e drejta, këtë ta kemi parasysh.

Mos të harrojmë se kreditorët janë të Kosovës dhe qytetarët e mijë nuk janë veç debitorë. Kështu që thjeshtë për mendimin tim numër një këtë duhet ta kemi parasysh se nëse ne e bëmë në një situatë qytetarin në këtë rast kreditorin që munden me e ndërrua a me hy drejtë vetë përmes institucionit që janë të rregulluara me ligj apo me fol me najë kon privatë ajo është diçka tjetër.

Mos të harrojmë se gjithmonë i kemi dy palë të barabarta në procedurë edhe gjithmonë ndëshkimi duhet me pagua ai që e ka shkel ligjin ose marrëveshjen. Nuk di pse ka nevojë mu pa në këtë prizëm Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Shala!

ISAK SHALA: Në krejt ligjin një dispozitë e jep mbrojtje debitorit krejt tjerat kreditori e favorizojnë.

MEHDI RESHANI: Absolutisht për mua kjo nuk qëndron.

AGIM ALIU : Nuk e pata ndërmend me marrë fjalën pa ju dy edhe nuk e kuptova, ... që debitori janë vetëm qytetarë.

Unë po përmendi me që e mora fjalën për herë të dytë si debitor komunat e Kosovës.

Kam qenë kryetar komune një kohë ja ku e kemi edhe nënkryetarin e komunës që realisht nënkryetar i komunës që do të jetë kryesuesi i grupit punues. Në këtë mënyrë si është duke shkuar te ne në Kosovë edhe komunat munden me falimentua, të keni parasysh ka probleme me këtë implementim të ligjit në mënyrën se si është ndëshkua edhe komunat munden me falimentua kushtimisht po them, kjo është pasojë edhe e menaxhimit e vetë kryetarëve të komunave sepse është një lloj qarku që po krijohet te operatorët ekonomik ata janë kreditorë dhe ndërsa në këtë rast komuna është debitor por besoni që shumë keq janë aktualisht se si është ligji në fuqi, dhashtë Zoti që të bëjmë adresim rreth kësaj çështje dhe të kësaj zgjidhje, po probleme definitivisht ka edhe po mendoj që duhet të ulemi ne nuk kemi asnjë lloj paragjykimi për askend, vetëm ne po themi si të gjejmë udhën e duhur që t'i adresojmë çka janë problemet dhe të dalim nga petku që kem.

SEFER ARIFI: Kryetare, nëse bënë veç shkurtimisht.

KRYETARJA: Vetëm një minutë të lutem.

SEFER ARIFI: Gjitha çështjet që i kemi duhet t'i adresojmë në këto grupet punuese, edhe po më pëlqen shumë që do të ketë disa.

Ka kërkesa, propozime nga ministritë e ndryshme nga të gjitha institucionet e Kosovës, ... me qindra raste ndërmarrjet publike edhe institucionet e Kosovës ministritë, doganat, aeroporti, agjensione që kanë me ardhur te përmbaruesi ose policia.

Ne tash me bo marrëveshje me institucionin të lokalit përmbarues me bë pak marrëveshje me arrit mes shteti me shtet, domethënë nuk vetem komuna po ka edhe institucione që kanë lëndë që vijnë te përmbaruesit. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit!

Para se me kalua edhe për fund te zoti Bajraktari, vetëm po dua me theksua që siç po shihet paskemi me pasur probleme edhe në grupin punues por besoj që për shkak të interesave të ndryshme të përfaqësuesve qoftë bankave apo përmbaruesve vetë por edhe të interesave të qytetarëve të cilat ne si deputet duhet ti mbrojmë patjetër.

Duhet me rifreskua pak qëndrimin e lëvizjes dhe ... për shkak se ne atë kohë nuk e kemi përkrahur projektligji për përmbaruesin privat pikërisht për faktin se kemi insistuar që të kemi përmbarues publik në mënyrë që ta kem përball para së gjithash interesin e qytetarëve të Republikës, kjo nuk patë kaluar në atë kohë.

Arsyet sepse e keni kundërshtuar këtë projektligj edhe në parim janë paka shumë të ngjashme me këto.

Unë mendoj që Ministria e Drejtësisë ka dështuar pikë së pari për t'i identifikuar problemet me të cilat po ballafaqohen në radhë të parë qytetarët e Republikës.

Unë personalisht nuk kam pasur punë me përmbarues privatë, mirëpo jam njoftuar nga shumë qytetarë të cilët kanë pasur jashtëzakonisht shumë probleme.

Ne s'mund ta përjashtojmë faktin që ka pasur përmbarues privatë duhet me pranua atë që kanë qenë jashtëzakonisht arbitrare në punën e tyre, nuk dua të përgjithësoj në asnjë rrethanë.

Ju keni pa edhe në media që janë ndalë edhe ndihmat sociale bagëti e qytetarëve, domethënë në qoftë se e shohim edhe këtë projektligj vërejmë që fundamentalist janë duke u mbrojtur interesat e kreditorëve e kreditorëve që nëse i shikojmë në spektrin e gjerë janë gjithsesi në pozitë më të volitshme se sa debitorët, që në të shumtën e rasteve janë qytetari që shpesh për shkak të nevojave ekstreme hynë në obligime të cilat pastaj nuk kanë mundësi që t'i përmbushin.

Unë nuk pajtohem me Ardianin që ky projektligj garanton siguri juridike, në qoftë se i lexojmë nenet ndryshimet që janë të propozuara nga Ministria e Drejtësisë vërejmë që i njëjti nuk garanton kurrfarë sigurie juridike dhe problemin e kanë që rëndën pozitën e debitorit në masë të madhe por edhe pajtohem me diskutimin e zotit Aliu.

Mua më vjen keq që këtu nuk kemi pasur mundësi që të ftojme qytetarë të cilët janë përball direkt me këto çështje.

Ne kemi ftuar përfaqësues të institucioneve, mirëpo jo edhe nga ata të cilët kanë qenë të prekur në vazhdimësi me këtë ligj.

Më duhet me theksua faktin që do të bëjmë përpjekje që në grupin punues me i adresua edhe problemet e atyre qytetarëve, mirëpo natyrisht që anëtarët e grupit punues do t'i marrin për bazë edhe disa nga vërejtjet të cilat u thanë në këtë takim.

Jam e bindur që nuk ka mundësi të ndryshojmë tash a të ketë përmbarues publik apo jo për shkak se tashmë është e rregulluar përmbarimi privat.

Mirëpo është dashur që të diskutohet edhe kjo mundësi, mirëpo po e shoh që tash më është e pamundur që të bëhen ndryshime të tilla.

Unë ju falënderoj shumë por po ja kaloj fjalën edhe zotit Bajraktari në mënyrë që ta jap një qëndrim pas diskutimeve që janë bërë.

ARDIAN BAJRAKTARI: Faleminderit, zonja kryetare!

Duhet të më lejoni dhe për fund në emër të Ministrisë së Drejtësisë në cilësi të sponsorizuesit që t'i falënderoj të gjithë akterët të përfshirë në këtë proces.

Fillimisht dua t'i them disa çështje që megjithatë nuk qëndrojnë .

E para, grupi punues nuk ka ... grupi punues është i mandatua për me hartua draftin cilindo draft në këtë rast, edhe draftin e këtij projektligji i cili pastaj i procedohet fillimisht ministrisë dhe aprovimit në Qeveri e pastaj edhe Kuvendit.

E rëndësishme është përherë përpiqemi që të kemi draft sa më ... domethënë ose reflekton turlifar çështje apo shqetësime të ngritura por jo më ...

Ajo çka desha të them para se gjithash çështjet e ngritura veçmas nga përfaqësuesi i Shoqatës së Bankave dhe përfaqësuesi i Odës Ekonomike Amerikane janë pothuajse të gjitha të harmonizuara në një letër që ju kemi nis ndërkohë dhe po shpresoj që në mirëkuptimin tuaj dhe me angazhimin e të gjithë akterëve këtu, këtu përmes amendamenteve do të reflektohen në projektligjin i cili do të jetë objekt shqyrtimi.

Kështu që faleminderit 3dhe një herë dhe ne me kënaqësi presim që të diskutojmë tutje dhe të arsyetojmë çdo propozim që e kemi bërë në kuadër të këtij drafti. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, Ardian!

Ju kisha lutë ata të cilët nuk i kanë dërgua vërejtjet me shkrim apo sugjerimet tjera me shkrim le t'i dërgojnë pranë Komisionit për Legjislacion, ata të cilët tashmë i kanë dërguar sepse disa për shembull shoqata e bankave i ka dërguar, sot e kam pranuar një të re, Ministrisë së Drejtësisë ende nuk i kemi, a i keni të përbashkëta.

_____: Kjo është e përbashkët.

KRYETARJA: Dakord.

Atëherë ata të cilët nuk i kanë proceduar le t'i procedojnë pranë Komisionit për Legjislacion.

Unë ju uroj punë grupit punues, nuk e di se sa kam me mujtë me marrë pjesë, domethënë që, do të mundohem domethënë me bë përpjekje me qenë e gatshëm.

Ju faleminderit shumë, dhe ju kisha lutë që brenda një afati Agim, a mi caktua afat për vërejtjet të cilat i kanë ndërkohë.

AGIM ADEMAJ: Jo vërejtjet sa më shpejtë le t'i binë...

KRYETARJA: Sa më shpejtë aq më lehtë është për të procedua..

AGIM ADEMAJ : Atëherë më lehtë na procedojmë, nuk vonohem në afate sa më shpejtë dorëzoni vërejtjet dhe ne ju njoftojmë për takimin e radhës.

KRYETARJA: Faleminderit, shumë!